



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315

E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202101137/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale(IEVP) Elbasan.*

**Drejtuar:** **Z. Agim ISMAILI**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve**

**TIRANË**

**Z. Agron ROKA**  
**Drejtor i IEVP-së Elbasan**

**ELBASAN**

*Të nderuar zotërinj,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Elbasan.

Inspektimi u krye në datë 09.09.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, respektimi i të drejtave dhe trajtimi i të paraburgosurve të garantuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Gjatë vizitës, administrata dhe punonjësit e sigurisë të IEVP-së Elbasan, i ofruan grupit të inspektimit të gjitha kushtet për akses të plotë në këqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit që kishte të bënte me qëllimin e vizitës monitoruese, për evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, ambientet e

përbashkëta për ajrim dhe aktivitete, si dhe për zhvillimin e intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, u zhvillua në kuadër të vizitave periodike për vitin 2021 që po zhvillon Mekanizmi Kombëtar (MKPT) në institucionet e sistemit penitenciar.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në burgje, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e IEVP Elbasan z.Agron Roka dhe shefin e policisë z.Hysni Ndreu, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të inspektimit.

Në takim, drejtuesi i institucionit informoi grupin e inspektimit për situatën e popullimit të të paraburgosurve në institucion, gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambientet e dhomave dhe atyre të përbashkëta në regjimin e brendshëm ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, masat e marra nga secili nga sektorët dhe shërbimi i sigurisë të institucionit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të të paraburgosurve në këto ambiente, mënyrën e funksionimit të sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes të kërkesë/ ankesave gjendjen shëndetësore dhe psiko-sociale të të paraburgosurve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Nisur nga infrastruktura e godinave në regjimin e brendshëm, elementët e sigurisë, cilësia e shërbimeve që ofrohen, si dhe ambientet e jashtme që shërbejnë për ajrim dhe aktivitete të përbashkëta, theksojmë se IEVP Elbasan garanton standarde të kënaqëshme për sa i përket kushteve për të paraburgosurit.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 8927/1, datë 27.09.2018, “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, i ndryshuar, IEVP Elbasan kategorizohet “institucion paraburgimi” i sigurisë së zakonshme.

Në vite, kapaciteti i institucionit ka pësuar ndryshime, për shkak të krijimit të ambienteve të reja të banimit dhe aktualisht kapaciteti fizik i miratuar i institucionit është për mbajtjen dhe sigurimin e **140 personave të paraburgosur**, ndërkohë që në ditën e inspektimit grupi i monitorimit konstatoi se ndodheshin **170 persona të paraburgosur**. Pra, institucioni kishte **30 persona të paraburgosur** mbi kapacitetin fizik dhe për pasojë kjo situatë mbipopulli kishte ndikuar në përkeqësimin e kushteve të jetesës të të paraburgosurve sidomos në dhomat e banimit ku ishin akomoduar 4, 6 dhe 8 persona. Kjo situatë e mbipopullimit, kishte cënuar parametrat e nevojshëm të hapësirës dhe sipërfaqes jetike për një person në dhomat e banimit dhe një pjesë e tyre flinin me dyshekë të vendosur në

tokë. Shkelja e këtyre standardeve bazike për jetesë, përbën trajtim jo dinjitoz të personave që vuajnë dënimin në kushtet e këtij institucioni.

Grupi i inspektimit, në vijim mori informacion për dinamikën e popullimit edhe për 6-mujorin e fundit, nga ku rezultoi se fenomeni i mbipopullimit ka qenë karakteristike në IEVP Elbasan për këtë periudhë. Më konkretisht:

1. Muaji Mars 2021	-	<b>158</b> persona të paraburgosur (+14 persona)
2. Muaji Prill 2021	-	<b>160</b> persona të paraburgosur (+ 20 persona)
3. Muaji Maj 2021	-	<b>157</b> persona të paraburgosur (+ 17 persona)
4. Muaji Qershor 2021	-	<b>160</b> persona të paraburgosur (+ 20 persona)
5. Muaji Korrik 2021	-	<b>163</b> persona të paraburgosur (+ 23 persona)
6. Muaji Gusht 2021	-	<b>170</b> persona të paraburgosur (+ 30 persona)

Nga inspektimi u konstatua se, një pjesë e të paraburgosurve që ishin mbi kapacitet, ishin të pajisur me shtretër për fjetje dhe të vendosur në dhoma të destinuar për 2, 4 dhe 6 persona, duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese. Ndërkohë që, grupi i inspektimit gjeti 10 persona të cilët nuk ishin të pajisur me shtretër dhe flinin me dyshekë të vendosur në tokë. Nga intervistat me këta të paraburgosur, ata kishin një periudhë prej 3-6 muaj që flinin me dyshekë të vendosur në tokë, për shkak të kësaj situatë të mbipopullimit.

Fenomeni i mbipopullimit është evidentuar nga MKPT edhe në inspektimin periodik të zhvilluar në datë 13.02.2020, ku rezultoi se IEVP Elbasan ka patur mbipopullime gjatë muajve të fundit të vitit 2019 dhe në disa periudha të caktuara gjatë vitit 2020. Në vlerësimin tonë, nisur nga fakti se IEVP Elbasan është institucion paraburgimi, situata e mbipopullimit veç mungesës të kapaciteteve akomoduese, është në varësi edhe të dinamikës të vendimeve që marrin gjykatat e shkallës së parë dhe ajo e apelit në Elbasan. Ndaj në kushtet të tilla, është tepër e domosdoshme që DPB e cila bën planifikimin e kapaciteteve akomoduese për çdo IEVP, të kërkojë dhe shpërndarjen e të paraburgosurve në IEVP e tjera më të afërta me prokuroritë dhe gjykatat e rrethit gjyqësor Elbasan, pasi në këto që jetojnë të paraburgosurit e kësaj IEVP, janë në kushte të trajtimit jo dinjitoz të tyre.

Godinat në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, garantonin sigurinë dhe kushtet e qëndrimit të të paraburgosurve, për kryerjen e veprimeve sipas orarit ditor, por dhe për të përballuar dinamikën e hyrjeve të reja dhe transferimit të të paraburgosurve në IEVP të tjera, situatë kjo që ndryshonte çdo ditë në varësi të vendimeve të gjykatave.

Organika e miratuar për IEVP Elbasan përbëhej nga 133 punonjës, nga të cilët 24 ishin punonjës civil dhe 109 punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë të institucionit. Mungesat konsistonin në 1(një) specialist te sektori i Burimeve Njerëzore dhe 1(një) specialist te sektori i Çështjeve Shoqërore, të cilat nuk ndikonin në ofrimin e shërbimeve dhe trajtimin e të paraburgosurve.

Grupi i inspektimit evidentoi dhe zbatimin e masave të protokollit anti COVID-19. Institucioni kishte një rregullore të brendshme për respektimin e këtyre masave nga punonjësit dhe të paraburgosurit në ambientet e regjimit të brendshëm, por dhe jashtë institucionit. Në hyrje të institucionit bëhej matja e temperaturës nga punonjësi i informacionit për stafin dhe vizitorët, si dhe kontrollohej pajisja e tyre me maskë mbrojtëse. Kjo procedurë evidentohej në një regjistër të veçantë.

Në vende të aksesueshme në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm, ishin vendosur dizifektantë për pastrimin e duarve, si dhe mbaheshin maska mbrojtëse nga punonjësit e administratës dhe të sigurisë. Në hyrje të institucionit ishte ndërtuar tunel dizifektues me solucionin VIROCID. Gjatë shoqërimit të të paraburgosurve për në gjykata, ata pajiseshin me maska mbrojtëse nga institucioni.

Në regjimin e brendshëm ishte hapur një sektor për karantinimin e të paraburgosurve, kur ata dilnin jashtë institucionit qoftë dhe për arsye të vizitave mjeksore pranë qendrave spitalore në Elbasan dhe në Tiranë, ose në klinika private.

Ambientet e brendshme dhe të jashtme të institucionit mbaheshin pastër nga ana higjieno-sanitare, si dhe ishin të dizifektuara çdo muaj sipas grafikut të hartuar nga DPB. Aktualisht nuk kishte asnjë anëtar stafi apo të paraburgosur të infektuar me COVID-19. Gjatë periudhës të pandemisë kishin rezultuar të prekur nga ky infeksion 7 anëtar të stafit të institucionit, të cilët ishin rikthyer në detyrë. Në kuadër të vaksinimit vullnetar, stafi i punonjësve të administratës dhe të policisë të institucionit, ishin vaksinuar të gjithë me dy doza, ndërsa të paraburgosurit ishin vaksinuar në masën 80%, për shkak se kishte prej tyre që kishin refuzuar bërjen e vaksinës.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 13.02.2020, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, si dhe intervistat konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi se:

1. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për dizinfektimin dhe lysterjen e ambienteve të banimit dhe atyre të përbashkëta, kjo në kuadër dhe të parandalimit të COVID-19.
2. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për pajisjen me autoambulancë të re të institucionit, me qëllim shoqërimin e të sëmurëve në rastet urgjente pranë Spitalit Rajonal Elbasan.
3. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për furnizimin me ujë të rrjedhshëm dhe ujë të ngrohtë, në ambientet e dhomave dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve.
4. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për rishikimin e strukturës organike të IEVP Elbasan, me qëllim ndarjen më vehte të sektorit juridik dhe krijimin e sektorit psiko-social.
5. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për kryerjen në kohë dhe pa vonesë të vizitave mjeksore të të paraburgosurve nga stafi mjekësor i institucionit, si dhe shoqërimin e tyre për vizita mjekësore pranë specialistëve në spitalin rajonal Elbasan.

6. **Ishte plotësuar rekomandimi**, që në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit dhe Qendrën e Formimit Profesional Elbasan, të hapen klasa për zhvillimin e mësimin dhe kurse për ushtrimin e profesioneve të ndryshme.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet ende nuk kishin gjetur zbatim dhe konkretisht:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për krijimin e ambienteve të veçanta në regjimin e brendshëm, për tharjen e rrobave të të paraburgosurve dhe heqjen e litarëve dhe rripave që varen në dhomat e banimit.
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për sigurimin e fondeve të nevojshme për kryerjen e investimeve dhe vënien në funksion të sistemit qendror ngrohës-ftohës.
3. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për plotësimin e organikës së institucionit me mjek me kohë të plotë.

### **Trajtimi i të paraburgosurve**

Objekti i vizitës inspektuese të grupit të monitorimit, ishte trajtimi i të paraburgosurve, identifikimi i rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative, apo presionit psikologjik ndaj tyre, si dhe përdorimi efektiv i masave disiplinore në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore kombëtare dhe aktet ndërkombëtare të fushës.

Nga informacioni që u grumbullua gjatë vizitës inspektuese dhe intervistimi i të paraburgosurve, grupi monitorues nuk konstatoi raste apo pretendime nga të paraburgosurit, lidhur me keqtrajtim apo tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të shërbimit të sigurisë apo e stafit të institucionit.

Grupi i inspektimit, në intervistat me të paraburgosurit evidentoi si shqetësimin kryesor përkeqësimin e kushteve të jetesës në disa dhoma banimi, për shkak të mbipopullimit të tyre mbi kapacitetin fizik që ato kanë; mungesën e aktiviteteve të larmishme, pasi zhvillohen vetëm aktivitete me karakter fetar, të cilat gjatë periudhës së pandemisë kanë qenë të ndaluara; mundësinë e shtimit të numrit të takimeve fizike mujore me familjarët; zgjatjen e kohës të furnizimit me ujë të rrjedhshëm në dhoma gjatë 24 orëve, pasi koha me grafik 3x1 orë në ditë është e pamjaftueshme për mbajtjen e higjenes personale dhe pastërtinë e ambientit të dhomave, sidomos në dhomat me përbërje 4, 6 dhe 8 persona, etj.

Gjithashtu, një problematikë që u evidentua gjatë intervistave me të paraburgosurit, kishte të bënte me mungesën e furnizimit rregullisht, sipas normativave mujore, me produkte të higjenes personale si sapun, letër higjениke, test për larjen e enëve të gatimit, pajisjeve për pastrimin e dhomave, si dhe me detergjentë.

Gjatë inspektimit, evident në këtë institucion ishte mosfunksionimi i sistemit qendror për ngrohje/ftohje në regjimin e brendshëm. Në mungesë të këtij sistemi, të paraburgosurve u ishte mundësuar futja e ventilatorëve freskues në periudhën e verës dhe kaloriferëve ngrohës në periudhën e dimrit. Në vijim të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve të

mëparshme të Institucionit të Avokatit të Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr.7729/2 prot., datë 11.08.2020, **na informon se**, “*është ngritur një komision për verifikimin e problematikave të sistemit ngrohje/ftohje mbështetur edhe nga kompania “Al Gjeoterm” dhe “...në buxhetin afatmesëm 2021-2023, do të shikohet mundësia e prioritizimit të investimeve për zgjidhjen e këtij problemi”*”.

Ankesat më të shumta që ju paraqitën grupit të inspektimit nga të paraburgosurit, kishin të bënin me pretendimin për vendimet të etiketuara prej tyre si të “padrejta” që marrin organi i prokurorisë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore për veprat penale që ju atribuohen, zvarritjen e zbardhjes së vendimeve të gjykatave që shkojnë dhe deri në 6 muaj nga dita e shpalljes së vendimit, mungesën efektive të avokatëve mbrojtës, etj., Por të paraburgosurve nga grupi i inspektimit ju dhanë këshillime ligjore për mënyrën e ndjekjes së këtyre ankesave, pasi nisur nga natyra që ato paraqiten, nuk janë objekt i shqyrtimit ligjor nga Mekanizmi Kombëtar dhe Institucioni i Avokatit të Popullit.

### **Masat mbrojtëse**

Nga intervistat me drejtuesit e institucionit dhe të paraburgosurit, si dhe verifikimi i dokumentacioneve, sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe rregulloren e brendshme të institucionit. Çdo ankesë e të paraburgosurve, regjistrohej në një regjistër të veçantë që mbahej në sekretarianë e institucionit dhe ishte e protokolluar<sup>1</sup>.

Të paraburgosurit plotësonin formularin e kërkesë/ankesës dhe ja dorëzonin punonjësit të sektorit psiko-social sipas sektorëve që mbulonin. Më tej, punonjësi i sektorit psiko-social e dërgonte kërkesën në sekretarinë e institucionit ku protokollohej dhe i kalonte Drejtorit të Institucionit për të bërë shënimet përkatëse. Në varësi të natyrës së ankesës, kërkuesit i kthehej përgjigje me shkrim nga sektorët përgjegjës ose drejtori i institucionit i takonte vetë të paraburgosurit.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, rezultoi se objekti i kërkesave të të paraburgosurve kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarët, kërkesë për takim me avokatë mbrojtës, vizitë mjeksore në spitalin rajonal Elbasan te mjeku specialist, kërkesë për punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigerifer.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, monitorohej nga sistemi CCTV me 115 kamera, të cilat mbanin në vëzhgim të gjitha mjediset në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit dhe ishte funksional. Kamerate monitoronin gjatë 24 orëve dhe të dhënat e tyre ruheshin në një server qendror për një periudhë 30 ditore.

Spektori i observimit dhe tranzitit ndodhej në katin e parë të godinës “A” dhe kishte 4 dhoma. Këto dhoma ishin të pajisura me krevat, dyshekë, materiale për fjetje dhe orenditë e nevojshme si tavolinë e karrige. Në momentin e inspektimit në këtë ambient gjendej

---

<sup>1</sup> Neni 10 i ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

vetëm një person, për përshtatje deri në sistemimin e tij në një nga sektorët e regjimit të brendshëm.

Ndërsa dhomat e veçimit ndodheshin në godinën “B”, dy dhoma në katin e dytë dhe dy dhoma në katin e tretë të kësaj godine. Dhomat e veçimit ishin të kompletuara me krevatë për fjetje dhe nuk kishte asnjë të paraburgosur me masë disiplinore.

Ambientet e observimit dhe të veçimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por ato kishin nevojë për lyerje dhe dizifektim.

Sistemi i telefonave ishte funksional dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se flisnin dy herë në javë me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në korridorin e secilit sektorë. Të paraburgosurit ngritën shqetësimin se nga dy aparate telefoni që ndodheshin në sektorë, vetëm njëri prej tyre punonte, ndërsa aparati tjetër ishte bllokuar nga kompania telefonike që kishte ndërprerë kontratën me DPB.

Takimet me familjet, të paraburgosurit vijonin ti kryenin të alternuara mes 3 takimeve online nëpërmjet platformës “Skype” dhe 1 takimi fizik në ambinetin e takimeve që ndodhej në katin e parë të godinës. Nga intervistat me të paraburgosurit nuk pati ankesa për mosrespektim të numrit të 4 takimeve në muaj. Takimet me familjarët zhvilloheshin sipas procedurave të miratuara në rregulloren e brendshme të burgjeve, me kërkesë të të paraburgosurve dhe miratim të drejtorit të institucionit.

Në ambientin e takimeve, ishte krijuar një mjedis i veçantë për “prindërimin në distancë”, ku të paraburgosurit takoheshin me familjet dhe fëmijë të vegjël, pa barriera apo kufizime fizike. Ambienti kishte hapsirën dhe sipërfaqen e nevojshme, por dhoma kishte nevojë për investime dhe pajisje me orenditë e nevojshme, për të qenë e përshtatëshme për qëllimin që ajo është krijuar.

IEVP Elbasan kishte në organikë 10 të paraburgosur të punësuar, të cilët punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Punësimi dhe shpërblimi i punës të paraburgosurve/dënuarve duhet të jetë i rregulluar në përputhje me nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*. Avokati i Popullit ka rekomanduar në vijimësi, për miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave, për punësimin dhe kriteret e shpërblimit për të dënuarit dhe të paraburgosurit<sup>2</sup>, për të bërë efektive të drejtën e punësimit dhe të shpërblimit për të paraburgosurit/dënuarit, që garantohen nga ligji dhe standardet ndërkombëtare.

## **Kushtet materiale**

---

<sup>2</sup> Nenet 43 pika 12 e ligjit nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Gjatë monitorimit të veprimtarisë së I EVP-së në kuadër të respektimit të të drejtave ligjore të të paraburgosurve, grupi i inspektimit evidentoi dhe problematikat që lidhen me plotësimin e kushteve të të paraburgosurve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, për garantimin e atyre të drejtave që lidhen me kushtet e jetesës dhe zhvillimin e aktiviteteve, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Godina kryesore në regjimin e brendshëm të I EVP Elbasan, është e ndarë në dy godina “A” dhe “B”, me katër sektorë në secilën godinë. Në katin e parë të godinës ndodhen ambientet e përbashkëta si dhomat për takimet me familjarët, guzhina, dhomat e observimit, dhomat e tranzitit, dhomat për takime me prokurorët dhe avokatët mbrojtës, si dhe ambientet për kryerjen e riteve fetare.

Veç tyre, në katin e parë ndodhen edhe disa ambiente (dhoma) të ndërtuara sipas projektit, por nuk kanë asnjë funksion dhe nuk janë në përdorim, ndaj dyert e tyre ishin të mbyllura dhe të vulosura.

Në katin e 2-të dhe të 3-të të godinave, ndodhen dhomat e banimit për akomodimin e të paraburgosurve. Në secilin nga katet e godinave, kishte nga dy sektorë me ndarje më vete. Ndërsa në pjesën e jashtme, godinat komunikonin me derë më vete me bokset e ajrimit dhe fushat e sportit. Çdo godinë kishte 2 bokse ajrimi dhe fusha sporti për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive të programuara.

Në secilin nga sektorët ndodheshin ambientet për akomodimin e të paraburgosurve, klasat e edukimit, si dhe ambientet e përbashkëta të dusheve. Sektori kishte në përbërje 10 dhoma banimi, një klasë për trajtimin psiko-social të të paraburgosurve, e cila shërbente njëkohësisht dhe si bibliotekë, si dhe një ambient dushi me dy poste për larjen e trupit, sipas grafikut të miratuar nga drejtori i institucionit.

Dhomat e banimit ishin me kapacitet për 2, 4 dhe 6 persona në dhomë. Por, për shkak të mbipopullimit, grupi i inspektimit konstatoi se në disa dhoma banimi ishin shtuar shtretër me dyshekë për fjetje dhe për pasojë ishte rritur numri i të paraburgosurve me 3, 6 dhe 8 persona në dhomë. Nga inspektimi u evidentua se jo të gjithë të paraburgosurit flinin në shtretër me dyshekë, pasi 10 të paraburgosur u gjetën që flinin me dyshekë të vendosur në tokë, për shkak të mungesës të shtretërve.

Situata e mbipopullimit, kishte krijuar gjithashtu vështirësi në plotësimin e kushteve të jetesës të të paraburgosurve, duke shkelur një nga kushtet dhe kriteret që duhet të sigurojë dhomat e banimit, atë për sipërfaqen dhe hapsirën e nevojshme jetike për një person, të përcaktuara qartë në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare të miratuara për këtë qëllim.

Konkretisht, në disa prej dhomave të banimit të shpërndarë në 4 sektorë të regjimit të brendshëm të I EVP-së, grupi i inspektimit gjeti 1-2 persona mbi kapacitetin e lejuar. Tejkalimi i normës prej 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person, konsiderohet si shkelje e standardit



të sipërfaqes së banimit për person, si dhe trajtim degradues e jo njerëzor.<sup>3</sup> Shkelja e këtij standardi është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare se: *“Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m<sup>2</sup> nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”*.

Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që lejonin ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishin të instaluar ndriçimin artificial nga rrjeti elektrik. Dhomat e banimit kishin brenda tualete, të pajisura me çezma, nyje hidrosanitare dhe furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm sipas grafikut 3x1 orë çdo ditë. Në dhomat e banimit që kishin të paraburgosur brenda kapacitetit, nuk kishte probleme që lidheshin me kushtet e jetesës dhe furnizimin me ujë. Ato ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno sanitare. Ndërsa, në dhomat që kishin mbipopullim, mundësia për mbajtjen pastër të higjienës personale dhe ambientit të dhomave, ishte e vogël, pasi koha e furnizimit me ujë nga çezma ishte e pamjaftueshme.

Furnizimi me ujë kryhej nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Elbasan, sipas grafikut të miratuar në marrëveshjen e përbashkët me IEVP Elbasan. Nga intervistat, të paraburgosurit paraqitën ankesa për furnizimin me ujë dhe kërkonin të zgjatej orari i furnizimit me ujë, pasi me 3 orë në ditë nuk plotësoheshin nevojat e të paraburgosurve për mbajtjen e pastërtisë së ambienteve dhe të higjienës personale.

Në tërësi, dhomat e banimit ishin të pajisura me orëditë e nevojshme si tavolina, stola dhe rafte për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimit të të paraburgosurve. Mungesa në pajisje u vërejtën në dhomat që kishin mbipopullim, pasi për shkak të sipërfaqes së vogël të dhomave dhe numrit të personave mbi kapacitetin e nevojshëm, ishte e pamundur mbajtja e tyre. Furnizimi me materialet për fjetje si dyshekë, batanije dhe çarçafë bëhej rregullisht nga sektori i logjistikës dhe ato ishin në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura.

Një nga shqetësimet e ngritura në intervistat me të paraburgosurit, kishte të bënte me larjen e teshave personale të të paraburgosurve, pasi në mungesë të lavanderisë të institucionit, ato laheshin nga familjarët e tyre ose dhe nga vetë të paraburgosurit. Ndërkohë tharja e rrobave, në mungesë të një ambienti më vete, vazhdonte të kryhej brenda dhomave të banimit, duke përdorur mjete të tilla si kordona apo litarë për varjen dhe tharjen e tyre. Mbajtja e kordoneve apo litarëve në dhomat e banimit përbën rrezik për jetën, kryesisht të atyre personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, por dhe për sigurinë e të paraburgosurve të tjerë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga kushtet në dhomat e banimit, mbipopullimin, por dhe rastet me pasojë vdekjen në IEVP Elbasan (si në rastin e vitit 2019) dhe IEVP-të e tjera, nga përdorimi i kordonave dhe litarëve si mjete për kryerjen e vetëvrasjeve, ka

---

<sup>3</sup> Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 30 e Rregullores së Përgjithshme të Burjeve.

rekomanduar në mënyrë të përsëritur, **heqjen e menjëhershme të këtyre mjeteve nga dhomat e banimit dhe krijimin e ambienteve të veçanta për tharjen e rrobave në çdo sektorë.**

Në përgjigje të këtij rekomandimi, DPB-ve ka sqaruar se krijimi më vete i ambienteve për tharjen e teshave në I EVP Elbasan është objektivisht i pamundur, pasi për shkak të numrit të lartë të të paraburgosurve, ka mungesë të ambienteve për akomodimin e tyre. Gjithashtu, në vijim të përgjigjes së këtij rekomandimi, informohemi se janë marrë masat e nevojshme për sigurinë e jetës të personave që kanë probleme të shëndetit mendor, duke i mbajtur ata në monitorim nga stafi mjeksor dhe stafi i sigurisë së institucionit për të parandaluar çdo rrezik jete që paraqesin këto mjete<sup>4</sup>.

Në fundin e korridorit të secilit prej sektorëve, ndodhej ambienti i përbashkët i dusheve që shërbente për larjen e trupit të të paraburgosurve. Ambienti i dusheve kishte dy poste me koka dushi funksionale dhe bolier për ngrohjen e ujit. Nisur nga numri i lartë i të paraburgosurve për çdo sektorë dhe koha e kufizuar e furnizimit me ujë të rrjedhshëm, **dushet nuk i përballonin kërkesat për larjen e trupit të të paraburgosurve.** Në këto kushte, një pjesë e të paraburgosurve ngrohnin ujin me pajisje elektrike dhe laheshin në dhoma. Nga intervistat me të paraburgosurit, larja e trupit kryhej 2 herë në javë, sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit. Ambientet e dusheve ishin të mirëmbajtura, por ato kishin nevojë për lyerje me bojë dhe dizinfektimin periodik. Nga inspektimi rezultoi **se ato nuk ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare.**

Ajrimi për të paraburgosurit kryhej në bokset e ajrimi më vete, të cilat ishin të ndara sipas sektorëve për arsye sigurie, por dhe konflikti të mundshëm mes të paraburgosurve. Ambientet e ajrimit ishin me hapsira të bollshme dhe shërbenin gjithashtu për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe atyre me karakter kulturor. Gjatë periudhës së pandemisë këto aktivitete kanë munguar, për shkak të kufizimeve të vendosura në aktet normative për parandalimin e COVID-19 në sistemin e burgjeve.

Aktivitetet me grupe të vogla dhe trajtimi psiko-social i të paraburgosurve, zhvillohej në ambientin e klasave që ndodheshin në çdo sektor, ndërsa ambientet e tjera që ndodheshin në sektorë si palestrat, ishin kthyer në ambiente banimi për shkak të mbipopullimit që vazhdon të jetëprezent në I EVP Elbasan.

Në ambientet e klasave, zhvilloheshin nga punonjësit e sektorit psiko-social aktivitete në grupe të vogla dhe trajtime individuale me të paraburgosurit, sipas planit mujor të aktiviteteve të miratuar nga drejtuesi i institucionit. Klasat kishin sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme, ajrim dhe dritë natyrale. Në to ndodheshin rafte me libra për lexim, si dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige, me qëllim zhvillimin e aktiviteteve që mundësojnë rehabilitimin e këtyre personave të privuar nga liria.

---

<sup>4</sup> Shkresë nr.7729/1 prot., datë 11.08.2020 e DPB drejtuar Avokatit të Popullit.

Ambienti i takimit me familjarët ndodhej në katin e parë të godinës dhe kishte 8 poste për takime fizike, prej të cilave në 2 poste ishin vendosur kompjutera për takime online, për shkak të masave kufizuese të pandemisë. Aktualisht, të paraburgosurit zhvillonin 1(një) takim fizik me familjarët dhe 3(tre) takime online, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e brendshme të burgjeve për 4 takime në muaj.

Bisedat telefonike me familjarët zhvilloheshin rregullisht me dy biseda në javë, nga telefonat me kartë që ishin vendosur në korridoret e sektorëve dhe në ambientin e ajrimit. Disa nga të paraburgosurit ngritën shqetësimin se bisedat telefonike gjatë ditëve të diela lejoheshin vetëm nëpërmjet një aparati telefonik që ndodhej në ambinetet e ajrimit. Koha e kufizuar e ajrimit dhe numri i vogël i aparateve telefonik që ndodhen në ambientet e ajrimi, nuk përballonin kërkesat e të paraburgosurve për të folur me familjet e tyre, pasi aparatet që ndodhen në sektorë nuk punonin ditëve të diela.

Sa i takon, bisedave telefonike me Institucionin e Avokatit të Popullit, nga intervistat me të paraburgosurit rezultoi se ata nuk mund të komunikonin në çdo kohë dhe pa pagesë, sikurse parashikohet në ligjin 81/2020. Ky shqetësim është ngritur nga të burgosurit dhe në IEVP e tjera, ndaj kërkohet që të vendoset si detyrim për kompaninë që ofron këtë shërbim, në kontratën e lidhur me DPB.

Në ambientin e takimeve të të paraburgosurve me familjarët e tyre, ndodhej dhoma e prindërimit në distancë dhe dhomat për takime speciale, të cilat për periudhën e pandemisë kanë qenë të mbyllura dhe aktualisht nuk ishin në përdorim. Gjendja higjieno-sanitare e dhomave që ndodheshin në ambientin e takimeve ishte e pastër.

Në këtë ambient, ndodheshin gjithashtu edhe dhoma e takimeve me avokatët mbrojtës dhe dhoma e takimeve me prokurorët e çështjes, të cilat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina pune dhe karrige, me këmbë të fiksuara në dysheme, për qëndrimin ulur të personave që qëndrojnë në këto ambiente.

Sipas informacionit të dhënë nga drejtori, sektori i logjistikës në bashkëpunim me punonjësit e shërbimit të sigurisë në regjimin e brendshëm, kryente furnizimin me detergjentë dhe mjetet e higjenes sipas normativave mujore për çdo të paraburgosur, praktikë kjo që ishte e evidentuar në një regjistër të veçantë. Por, nga intervistat me të paraburgosurit u paraqitën ankesa se normativat mujore të detergjenteve nuk merreshin rregullisht ndaj dhe higjiena e ambinetit të dhomave të banimit ku kishte mbipopullim, linte për të dëshiruar.

Në IEVP Elbasan nuk kishte një njësi tregtare për blerjen e produkteve të nevojshme për të paraburgosurit, por nga informacioni i drejtuesve të institucionit, nuk kishte oferta nga subjektet private për ta kryer këtë shërbim. Mungesa e njësisë tregtare, përbente shqetësim për të paraburgosurit që kishin vendbanimin e familjeve larg, si dhe për shtetasit e huaj, në plotësimin e nevojave për blerjen e mjeteve personale dhe produkteve ushqimore.

Kuzhina e institucionit funksiononte në kushte shumë të mira dhe ishte e plotësuar me pajisjet e gatimit dhe sistemit të aspirimit të avujve. Pajisjet ishin të standardeve bashkëkohore industriale të vendosura së fundmi. Ambienti i kuzhinës ishte me hapësirë dhe kishte dritë dhe ajrim, si dhe ishte i pastër e i lyer.

Në organikën e institucionit ishin 4 (katër) kuzhinierë dhe 2 (dy) ndihmës kuzhinier nga lista e të punësuarve të paraburgosur. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore, ndërsa menyuja ditore dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës ishin të afishuar në stendë më vete. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu, për 9(nëntë) të paraburgosur të sëmurët diabetikë, ushqimi gatuhej më vete. Kushtet e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit nga ambienti i kuzhinës në çdo sektor, sikurse u konstatua nga grupi i inspektimit, kryheshin me vaska dhe enë kuzhine të nikeluara e të pastra, si dhe karroca në gjendje të rregullt. Nga intervistat me të paraburgosurit, u evidentua se ushqimi në masën më të madhe konsumohej prej tyre.

### **Regjimi dhe aktivitetet**

Orari i veprimeve në regjimin e brendshëm ishte i miratuar dhe i afishuar në ambientet e regjimit të brendshëm si te vendi i kolonës ku qëndronte personeli i shërbimit të sigurisë për secilin sektor, në ambientet e klasave të edukimit, si dhe në vende të dukshme në ambientet e ajrimit. Ai përmbante veprimet e aktivitetit ditor, si dhe aktivitetet kulturore dhe sportive që zhvillohen sipas programit me të paraburgosurit.

Gjatë periudhës së pandemisë, për shkak të kufizimit, programi i sektorit të çështjeve shoqërore përmbante vetëm aktivitete sportive me grupe të vogla kryesisht lojra tavoline, monitorim të vazhdueshëm të personave me probleme të shëndetit mendor dhe grupeve vunerabël, si dhe trajtime të ndryshme psiko-sociale individuale të të paraburgosurve me programe specifike që ndiqej nga grupi i përbërë nga psikologu, mjeku i IEVP-së dhe specialist i grupit të sigurisë.

Në intervistat me të paraburgosurit u ngrit si shqetësim, mungesa për një periudhë të gjatë e aktiviteteve kulturore e sportive me pjesëmarrje të gjerë, për shkak të masave anti COVID-19. Referuar faktit që pjesa më e madhe e të paraburgosurve ishin të vaksinuar, ata kërkonin që të organizohen sa më shumë aktivitete të larmishme. Drejtuesi dhe stafi i sektorit të çështjeve shoqërore të këtij institucioni na informuan se, në varësi të urdhërave dhe udhëzimeve të DPB-së do të planifikohen dhe organizohen aktivitete që janë në interes të të paraburgosurve.

Grupi i inspektimit, në intervistat me të paraburgosurit evidentoi disa kërkesa që kishin të bënin me hapjen e kurseve profesionale të organizuar në bashkëpunim me qendrën e formimit profesional të Elbasanit. Në këtë aspekt, drejtori i institucionit na informoi se, kishte zhvilluar takime me drejtorin e Zyrës Arsimore dhe drejtorin e Qendrës së Formimit Profesional në Elbasan, ku kanë rënë dakort që brenda muajit Dhjetor 2021 në këtë

institucion, të hapet klasa për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar, si dhe ndjekja e disa kurseve profesionale si ai për hidraulik, elektrikist, punime artizanale, etj., sipas kërkesave e interesave që kanë treguar të paraburgosurit, gjatë intervistimit që ka kryer stafi i çështjeve shoqërore të institucionit.

Marrja e këtyre masave efikase, shkon dhe më qëllimin që kanë institucionet e mbyllura penitenciare, i cili është riintegrimi në shoqëri i personave të burgosur, në momentin kur ata do të lënë burgun. Sa më sipër, Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*<sup>5</sup>.

Grupi i inspektimit, verifikoi dhe mënyrën e plotësimit të dosjeve të punës nga punonjësit e sektorit psiko-social për çdo të paraburgosur, lidhur me të dhënat paraprake të personalitetit të secilit prej tyre, historikun e tij, gjendjen e marrëdhënieve me të burgosurit e tjerë dhe stafin e institucionit, llojin e aktiviteteve që motivojnë, probleme të shfaqura me qëndrimin, sjelljen dhe përshtatjen në institucion, etj.

Nga inspektimi i dosjeve rezultoi se, ato ishin të plotësuara sipas rubrikave që përmban dosja, kishte të hartuar programe për trajtime individuale, pasqyrim të aktivitete të përbashkëta kryesisht atyre me diskutime në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit ose në klasat e edukimit, si dhe organizim të aktiviteteve sportive. Sikurse e theksuam edhe më lart, gjatë periudhës së pandemisë kanë munguar aktivitetet e larmishme në bashkëpunim me qendra kulturore apo sportive të qytetit të Elbasanit, takime me shkrimtarë, artistë dhe figura publike të qytetit, të cilat krijojnë atmosferë ndryshe të këta persona dhe ndikojnë në edukimin e tyre.

Spektori i çështjeve shoqërore, ishte ndarë me strukturën e re organike nga sektori juridik dhe kishte në përbërje 1 shef sektori dhe 3 specialistë me profesion psikolog dhe punonjës social. Aktualisht, sipas strukturës organike sektori kishte mungesa në 1 specialist, ndërsa 1 specialist tjetër ishte i transferuar me urdhër të DPB në IEVP tjetër. Pra, efektivisht sektori kishte mungesa në dy specialist dhe kjo reflektohej në cilësinë e veprimtarive që organizoheshin me të paraburgosurit.

Kontaktet me familjarët mbaheshin përmes takimeve fizike, takimeve online dhe telefonatave, të cilat ishin të planifikuara në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe urdhërave në zbatim të protokollit shëndetësor të miratuar për parandalimin e COVID-19 në burgje.

Në IEVP Elbasan, funksiononte biblioteka e cila ishte e pasur me tituj të rinj të librave, si dhe në çdo klasë edukimi kishte rafta me libra, në dispozicion të të paraburgosurve që

---

<sup>5</sup>Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2;  
<http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

kishin interes për lexim, brenda inventarit të librave të institucionit. Të paraburgosurit e regjistruar në bibliotekë, kishin hapur kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave. Nga informacioni, furnizimi i fundit me tituj të rinj të librave, ishte bërë gjatë vitit 2020.

### **Shërbimi Shëndetësor**

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës inspektuese në IEVP Elbasan, i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor të të paraburgosurve, për garantimin dhe ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe i krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Sipas strukturës organike të re të institucionit, personeli mjekësor përbëhej nga 7 punonjës, nga të cilët 1(një) mjek i përgjithshëm, 1(një) stomatolog, 1(një) farmacist dhe 4 (katër) infermierë. Përgjegjësi i sistemit shëndetësor ishte mjek neurolog në organikë të spitalit rajonal Elbasan dhe njëkohësisht i punësuar në këtë institucion me kohë të pjesshme. Ndërkohë, në ndryshim nga organika e mëparshme, personeli shëndetësor ishte shtuar me një farmacist dhe mjekun stomatolog, të cilët punonin me kohë të plotë, duke plotësuar edhe rekomandimin e lënë nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT-ja), gjatë vizitës që ka zhvilluar në vitin 2018 në Shqipëri, për plotësimin e organikës të sektorit shëndetësor me specialistë me kohë të plotë, si dhe pajisjen e kabinetit stomatologjik me një poltron dentar <sup>6</sup>. Vlen të theksojmë se, rekomandimet e CPT-së janë në të njëjtën linjë me rekomandimet e Avokatit të Popullit në inspektimet e vitit 2018 dhe 2019.

Ambienti ku zhvilloheshin vizitat mjekësore, ndodhej në godinën kryesore në regjimin e brendshëm, i cili ishte i veçuar nga ambientet e tjera. Dhomat e vizitave dhe ato për shtrimin e të paraburgosurve, ishin me hapësirë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, të ajrosura dhe kishin ndriçim natyral dhe nga rrjeti elektrik. Gjithashtu, ato ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në këtë ambient ndodheshin 3 (tre) dhoma për shtrimin e të paraburgosurve, dhoma e mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia, dhoma e infermierëve dhe një dhomë me 3(tre) shtretër për rastet e urgjencave.

Dhoma e mjekut ishte e plotësuar me shtrat, tavolinë, dollap për mbajtjen e mjeteve të punës të mjekut dhe ishte e lyer. Gjithashtu, kabineti stomatologjik ishte i plotësuar me kabinetin e nevojshëm të punës, duke përfshirë dhe poltronin i cili ishte i ri.

Furnizimi me ilaçe i të paraburgosurve të sëmurë kronikë kryhej rregullisht sipas skemës të ribursimit, e cila ishte në funksion të plotë, sipas skemës trepalëshe mes institucionit, depos farmaceutike dhe Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (DRFSKDSH). Gjithashtu, institucioni ishte furnizuar me

---

<sup>6</sup> CPT report on Albania 2014 faqja 17

[https://www.ecoi.net/en/file/local/1336989/1226\\_1457424142\\_2016-07-inf-eng.pdf](https://www.ecoi.net/en/file/local/1336989/1226_1457424142_2016-07-inf-eng.pdf)

medikamente, materiale mjekësore dhe materiale stomatologjike, nga depo farmaceutike e DPB. Në rastet e të sëmurëve akutë, përsa i përket medikamenteve që nuk rimbursohen, institucioni kishte në dispozicion dhe një fond që mundësonte blerjen e tyre.

Vizitat mjeksore kryheshin rregullisht, në bazë të kërkesave që paraqisnin të sëmurët e paraburgosur, dhe për nevoja të vizitave mjeksore më të specializuara, sipas rekomandimit të tij, planifikohej dhe kryhej vizita pranë mjekëve të Spitalit Rajonal Elbasan. Pavarësisht konstatimit tonë, grupi i inspektimit në intervistat me të paraburgosur, disa prej tyre, ngritën shqetësimin në lidhje me kryerjen me vonesë të vizitave mjekësore dhe kryesisht në vonesa të planifikimit të vizitave mjekësore pranë specialistëve të Spitalit Rajonal Elbasan. Nga informacioni me mjekun dhe drejtuesit e institucionit që mori grupi i inspektimit, na u sqarua se këto vonesa kanë konsistuar në përputhje me zbatimin e protokollit shëndetësor të COVID-19 dhe të karantinimit të tyre, pas kthimit nga vizita mjeksore.

Në vlerësimin e institucionit tonë, nisur nga kushtet që ndodhen të paraburgosurit që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare, ku mundësia për të patur alternativa për marrjen e shërbimit shëndetësor në kohë dhe me cilësi është e kushtëzuar, prezenca me kohë të plotë e personelit mjekësor, merr rëndësi të veçantë. Kjo për të shmangur situatat që mund të paraqiten në rastet e urgjencave, të cilat personeli i mesëm i infermierëve, nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda për të paraburgosurit e sëmurë. Po ashtu, kufizimet e vendosura për shkak të situatës së pandemisë, duhet të jenë në raport me gjendjen shëndetësore dhe ruajtjen e shëndetit të të paraburgosurve.

Vonesat në miratimin e kërkesave të të paraburgosurve sipas rekomandimit të mjekut të institucionit, për kryerjen e vizitave mjekësore pranë mjekëve specialist nga drejtuesit e këtij institucioni, shkaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për akses te mjeku specialist i personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë e cila është interpretuar dhe në qëndrimet e KPT (CPT-së) në këtë çështje, duke rekomanduar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre”* dhe se *“shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*.

Për garantimin e kësaj të drejte bazike të të burgosurve, sjellim në vëmendjen tuaj dhe Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*<sup>7</sup>.

Theksojmë se, institucioni ishte kompletuar me ambulancë të re, e cila bënte shoqërimin e të sëmurëve dhe rasteve të urgjencës, për në Spitalin Rajonal të Elbasanit, brenda të

---

<sup>7</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

gjitha kushteve dhe standardeve bashkohore, në ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë të këtyre personave.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan kishte një Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV), në të cilin gjatë periudhës Janar – Shkurt 2020 janë trajtuar 10 (dhjetë) persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në një dollap të mbyllur me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyrën regjistri i vizitave të mjekut dhe regjistrat e informacionit të shërbimit 24 orësh të infermierëve, të cilët ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull.

Grupi i inspektimit i kushtoi një vëmendje të veçantë dhe regjistrin të evidentimit të rasteve të dhunës fizike. Plotësimi i regjistrin dhe formatet e kontrollit mjekësor ishin sipas kërkesave të Protokollit të Stambollit, lidhur me evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës.

Gjatë vizitës inspektuese dhe intervistave me të paraburgosurit, u konstatua se, në tërësi të paraburgosurit ishin të pajisur me libreza shëndetësore. Për shkak të dinamikës së lëvizjeve të shpeshta të të paraburgosurve, kishte raste të mospajisjes me këto libreza shëndetësore. Ndërkohë, personeli mjekësor ishte duke punuar për plotësimin me libreza shëndetësore të të gjithë të paraburgosurve.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se:

*“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, në bazë të nenit 81 pika 1 dhe 2/b të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se:*

*“1. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim mekanizmi kombëtar, i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.*

*2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”;*

## **REKOMANDOJMË:**



1. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e mbipopullimit në IEVP Elbasan, pasi kjo situatë ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave jetike të personave të paraburgosur që vuajnë dënimin në këtë institucion, si dhe përbën shkelje të standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të veçanta brenda ambienteve të godinës së banimit, për tharjen e rrobave të të paraburgosurve dhe heqjen e menjëhershme për arsye sigurie për jetën e tyre të litarëve, rripave dhe mjeteve të tjera në dhoma, që përdoren për tharjen e rrobave.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin e numrave të telefonit të kontaktit me Avokatin e Popullit në vende të aksesueshme për të paraburgosurit, si dhe lejimin e bisedave telefonike me institucionin tonë, në çdo kohë dhe pa pagesë.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për disinfektimin e vazhdueshëm dhe lyerjen e ambienteve të banimit dhe atyre të përbashkëta.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për sigurimin e fondeve lidhur me investimet që duhen kryer për të pajisur këtë institucion me sistem qëndror ngrohës-ftohës.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, në bashkëpunim me ujësjellësin e qytetit Elbasan, për rishikimin e kontratës midis palëve për zgjatjen e orarit të furnizimit me ujë të rrjedhshëm të IEVP Elbasan, ose për shtimin e kapacitetit të depozitave për të përballuar furnizimin me ujë në çdo kohë të ambienteve në regjimin e brendshëm, me qëllim mbajtjen e higjenes të paraburgosurve dhe pastërtisë të ambienteve .
7. Marrjen e masave të nevojshme për kompletimin e organikës së institucionit me mjek, me kohë të plotë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme në përmirësimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor të të paraburgosurve të sëmurë, në kohë dhe pa vonesa nga ana e stafit mjekësor të institucionit, si dhe shoqërimin e tyre për vizita mjekësore pranë Spitalit Rajonal Elbasan.
9. Marrjen e masave të menjëhershme, për planifikimin dhe rritjen e larmisë së aktiviteteve kulturore e sportive me pjesëmarrjen e një numri më të madh me të paraburgosur, në bashkëpunim me qendrat kulturore dhe sportive të qytetit të Elbasanit, si dhe për kompletimin e bibliotekës me tituj të rinj të librave.
10. Marrjen e masave të nevojshme, në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Elbasan, për ofrimin e kurseve profesionale të të paraburgosurve në institucion apo zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për formimin profesional të tyre.
11. Marrjen e masave për plotësimin e organikës së institucionit me 1 specialist në sektorin e çështjeve shoqërore.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**